

HARTIMI I RREGULLAVE DHE NORMAVE NË PROFESION

Në shoqërinë njerëzore, në përgjithësi, por edhe në çdo shoqëri, veç e veç, ushtrohen **profesione të ndryshme, të lloj-llojshme**, dhe të rëndësishme për jetën e njeriut dhe të shoqërisë.

Në çdo profesion hyjnë në **raporte të caktuara punëdhënësit, punëtorët** dhe, në një mënyrë ose një tjetër, edhe **njerëzit e tjerë**, që mund të kenë lidhje me një profesion përkatës.

Për **rregullimin e marrëdhënieve të individëve brenda grupit** të një profesioni, janë krijuar **rregullat ose rregulloret, normat dhe ligjet**. Ato duhet të **respektohen** nga çdo individ, për të mundësuar **funksionimin normal** të grupit profesionist.

Rregullat, normat dhe ligjet e çdo profesioni, mbështeten në aktet normative juridike: **në ligje dhe në kushtetutë**.

Qëllimi i krijimit të rregullave, normave dhe ligjeve, që ushtrohen në profesione të ndryshme, është:

- **stimulimi i sjelljeve dhe i veprimeve të mira, të dobishme, pozitive**, dhe
- **pengimi i sjelljeve dhe i veprimeve, të këqia, të dëmshme, negative**, që mund të shfaqen në kushte e rrethana të caktuara.

Në hartimin e këtyre akteve, dokumentave, që janë në interesin e ushtrimit të profesionit përkatës, gjithmonë duhet të kihet parasysh **mospengimi, moskufizimi i të drejtave të njeriut, i të drejtave të fëmijëve**.

Megjithëkëtë, pothuajse nuk ka rregullore, normë apo ligje aq **gjithëpërfshirëse**, me të cilën do të ishin plotësisht të kënaqur **të gjitha palët** brenda një profesioni.

Çështja më **problematike, në raportet brenda një profesioni**, është dhe mbetet **rregullimi apo harmonizimi**:

- i përcaktimit të **kontributit të individit** në vendin e punës, dhe
- i ruajtjes së **integritetit personal** të individit në vendin e punës.

Rregullimi apo harmonizimi i këtij raporti (kontributi-integriteti) mund të çojë në njërin nga këto dy rreziqe:

1. **Favorizimi i organizatës dhe i punëdhënësit**, në dëm **të përfilljes dhe humanizimit të individit**,
2. **Respektimi i normave morale**, që e **favorizojnë individin**, por që **nuk pëlqehen nga organizat dhe punëdhënësi**.

Raste të tilla hasen në çdo **fushë të veprimit**, në çdo profesion, pra edhe **në profesionin e mësuesit**, në shkollë, në arsimim-edukim.

ETIKA E MËSIMDHËNËSIT

Për **mësimdhënësin**, për **punën e angazhimin e tij me nxënës**, për **kontributin dhe, sidomos, për etikën profesionale** të tij, **është folur dhe është shkruar shumë**.

Kualifikimet janë, kryesisht, **pozitive apo negative?**

Kualifikimet për etikën profesionale të mësimdhënësit bëhen zakonisht për **individët**. Në prononcimet e tyre, **shoqëria dhe familjet veçojnë mësuesit e dalluar**, në rastin e ndonjë përvjetori ose në **Ditën e Mësuesit**.

Interesimi i shoqërisë, i politikës, për mësimdhënësit lidhet me periudha kohore të caktuara. Ky interesim **rritej para reformave**, para kthesave të mëdha në arsim, kur për mësimdhënësit, për etikën dhe punën humane të tyre, për rolin dhe përgjegjësitë e tyre, flitej e shkruhej më shumë, ngritej paga e tyre, qoftë edhe simbolikisht.

Në periudha të tjera kohore, **në kohë krizash dhe ngeclesh në shoqëri**, **fajësoheshin mësimdhënësit** për **largimin nga misioni** i tyre dhe nga **ideologjia qeverisëse e kohës**.

Tipat e mësimdhënësve

Varësisht nga **(mos)angazhimi** i mësimdhënësve në kryerjen e misionit të tyre, sidomos në rrafshin ideologjik, flitet për këta tipa të mësimdhënësve:

1. Mësimdhënësit e përcaktuar ideologjikisht

Krahas misionit të tyre **profesional**, mësimdhënësit e përcaktuar ideologjikisht ushtrojnë edhe **ndikimin ideologjik** mbi nxënësit. Këta mësimdhënës janë anëtarë partie ose “njerëz të besueshëm” të partisë.

Shkaqet e përcaktimit ideologjik të mësimdhënësve mund të jenë të ndryshme:

- **Vetë besojnë** në një ideologji të caktuar;
- Ideologjia u është **imponuar**.

Mësimdhënësit e përcaktuar ideologjikisht mund të punojnë edhe në **konspiracion, në kërkimin dhe rekrutimin** e anëtarëve të rinj për partinë e tij.

2. Mësimdhënësit e baraspeshuar ideologjikisht

E ushtrojnë me **profesionalizëm** misionin e tyre. Janë **të kujdesshëm, të përmbajtur** dhe, në komentimin e ngjarjeve politike, **nuk kanë prapavijë ideologjike**. Përpiqen t'i **anashkalojnë pyetjet me ngjyrosje politike** ose **japin përgjigje të matura, të baraspeshuara ideologjikisht**.

3. Mësimdhënësit e painteresuar ideologjikisht

Misionin e tyre dhe **punën në shkollë** nuk i **ngatërrojnë me punët personale** dhe **me punët publike**. E ushtrojnë **me profesionalizëm misionin** e tyre edukativ-arsimor. Bisedojnë **lirshëm, nga këndvështrime të ndryshme**, për zhvillimet shoqërore. **Konstatimet i bazojnë në argumente**. Janë të **hapur** dhe **dëgjojnë kundërrargumentet** e të tjerëve. **Nuk nxjerrin gjykime të ngutshme** dhe nuk **heqin dorë lehtë nga qëndrimet e tyre**. Janë **korrekt, të paanshëm** dhe **gëzojnë autoritet** në rrethin shoqëror.

4. Mësimdhënësit me prirje pragmatiste-konstruktive

Me fjalë, me sjellje dhe me vepra angazhohen:

- Për **tejkalimin e të gjitha pengesave**, të çdo natyre,
- për **kryerjen e misionit** të tyre,
- për **afirmimin e kulturave**,
- për **zhdukjen e ndasive**, dhe
- për **integritet global**.

Sigurisht që ekzistojnë edhe **tipa të tjerë** mësimdhënësish.

Mësimdhënësi duhet të jetë **personalitet i gjithanshëm, me botëkuptim të gjerë, me arsimim-edukim të lartë, njohës i mirë i profesionit** të tij: **i aftë** në kuptimin **teorik, pedagogjik-psikologjik dhe praktik-metodologjik**.

Politikisht, ai duhet të jetë **i pandikuar, human, progresiv, i hapur ndaj risive** dhe ndryshimeve, **i gatshëm për ndryshimin e vetvetes**, për të ndryshuar të tjerët.

PYETJET:

1. Në çdo profesion hyjnë në **raporte të caktuara**:
 - a)
 - b)
 - c)
2. **Rregullat dhe normat** janë krijuar për të rregulluar
..... brenda grupit të një profesioni.
3. **Rregullat dhe normat** e çdo profesioni, kanë mbështetje në:
 - a) dhe
 - b)
4. **Qëllimi** i krijimit të rregullave dhe normave është:
 - a), dhe
 - b)
5. Në hartimin e rregullave dhe normave të çdo profesioni, duhet të kihet parasysh:
 - a) Vetëm mospengimi, moskufizimi i **të drejtave të fëmijëve**,
 - b) Edhe mospengimi, moskufizimi i **të drejtave të njeriut**.
6. Çështja më **problematike, në raportet brenda një profesioni**, është dhe mbetet **rregullimi apo harmonizimi**:
 - a), dhe
 - b)
7. Rregullat dhe normat brenda një profesioni, duhet:
 - a) të favorizojnë **organizatën dhe punëdhënësit**,
 - b) të respektojnë normat morale, që e **favorizojnë individin**,
 - c) të **harmonizojnë interesat** e punëdhënësit dhe të punëtorëve.
8. **Vlerësimet** për etikën profesionale të mësimit bëhen zakonisht për:
 - a) **individët**,
 - b) **grupin**.
9. **Interesimi i shoqërisë**, i politikës, për mësimit, lidhet me **periudha kohore të caktuara**:
 - a) Po,
 - b) Jo.

10. Mësimdhënësit, të cilët, krahas misionit të tyre profesional, ushtrojnë edhe **ndikimin ideologjik** mbi nxënësit, ideologjikisht janë të

11. Mësimdhënësit, të cilët misionin e tyre e ushtrojnë me profesionalizëm, që **janë të përmbajtur** dhe, në komentimin e ngjarjeve politike, **nuk kanë prapavijë ideologjike**, që përpiqen t'i **anashkalojnë pyetjet me ngjyrosje politike ose japin përgjigje të matura**, ideologjikisht janë të

12. Mësimdhënësit, të cilët misionin e tyre dhe **punën në shkollë** nuk i ngatërrojnë me **punët personale dhe me punët publike**, ideologjikisht janë të

13. Mësimdhënësit, të cilët **me fjalë, me sjellje, me vepra**, angazhohen për tejkalimin e pengesave, për kryerjen e misionit të tyre, për afirmimin e kulturave, për zhdukjen e ndasive, dhe për integritime globale, kanë ...

14. Mësimdhënësi **duhet të jetë**:

- a)
- b)
- c)
- d)
- e), etj.

